



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 27

2001

Qershor

PËRMBAJTJA

Ligj nr.8678
datë 14.5.2001

Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së
Drejtësisë.....

817

L I G J
Nr.8678, datë 14.5.2001

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E MINISTRISË SË DREJTËSISË

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj përcakton rregullat e organizimit, të funksionimit, si dhe fushat e veprimtarisë së Ministrisë të Drejtësisë.

Neni 2
Baza juridike e organizimit dhe e funksionimit të Ministrisë së Drejtësisë

Ministria e Drejtësisë organizohet dhe funksionon në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, me dispozitat ligjore për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave, si dhe me dispozita të tjera ligjore që parashikojnë rregulla të organizimit, funksionimit dhe kompetencave për Ministrinë e Drejtësisë.

Neni 3
Akte nënligjore për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë

Në këtë ligj parashikohen çështjet me të rëndësishme të strukturës, organizimit dhe të funksionimit të Ministrisë së Drejtësisë, ndërsa rregullimi i hollësishëm i këtyre çështjeve përcaktohet në Rregulloren e Ministrisë së Drejtësisë dhe në urdhrat e udhëzimet e Ministrit të Drejtësisë.

Neni 4
Statusi i funksionarëve politikë dhe i nëpunësve civilë

1. Funksionarët politikë të Ministrisë së Drejtësisë gëzojnë të drejtat dhe përmbushin detyrimet e parashikuara për ta në dispozitat ligjore përkatëse.

2. Nëpunësit civilë të Ministrisë së Drejtësisë gëzojnë të drejtat dhe përmbushin detyrimet e parashikuara në ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, ndërsa për punonjësit e tjerë zbatohen ato të parashikuara në Kodin e Punës.

3. Gjyqtarët dhe prokurorët mund të pranohen dhe shërbejnë në nivelet drejtuese a ekzekutive të strukturave juridiko-profesionale të Ministrisë së Drejtësisë.

4. Pranimi dhe emërimi i gjyqtarëve a prokurorëve bëhet pasi të jetë dhënë pëlqimi, përkatësisht, nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë ose Prokurori i Përgjithshëm, sipas kërkesës së Ministrit të Drejtësisë. Për vendet vakante në nivelet drejtuese dhe ekzekutive të strukturave juridiko-profesionale të Ministrisë së Drejtësisë, pranimi dhe emërimi bëhet pa konkurs.

5. Periudha e ushtrimit të funksionit politik a të shërbimit civil në strukturat e përmendura në pikën 3 të këtij neni, njihet si periudhë vjetërsie në punë si gjyqtar a prokuror për efekt të kërkesave të karrierës profesionale, të parashikuara në dispozitat ligjore për organizimin e pushtetit gjyqësor,

Gjykatën e Lartë, Gjykatën Kushtetuese dhe prokurorinë.

6. Gjyqtarët a prokurorët që shërbejnë në strukturat e përmendura në pikën 3 të këtij neni, me kërkesë të tyre, riemërohen gjyqtarë a prokurorë pa konkurs.

KREU II FUSHA E VEPRIMTARISË

Neni 5

Misioni i Ministrisë së Drejtësisë

1. Ministria e Drejtësisë, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet, ushtron funksione dhe ka në kompetencë hartimin dhe ndjekjen e politikave, përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe ushtrimin e shërbimeve të nevojshme lidhur me sistemin gjyqësor, sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale a civile, sistemin e shërbimeve të lira juridiko-profesionale, bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën civile dhe penale, fushat e tjera të drejtësisë dhe të kompetencës së saj sipas ligjit, si dhe për bashkërendimin, harmonizimin dhe reformimin e legjislacionit shqiptar në tërësi.

2. Në ushtrimin e veprimtarisë së saj, Ministria e Drejtësisë ka për qëllim të kërkojë respektimin e Kushtetutës, të ligjeve, realizimin dhe mbrojtjen e dinjitetit, të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, si dhe të kontribuojë në parandalimin e shkeljeve të ligjit, në përputhje dhe në funksion të kërkesave të zhvillimit demokratik dhe të integritetit evropian të Republikës së Shqipërisë.

3. Ministria e Drejtësisë, në përputhje me ligjin, mbështet, bashkëpunon dhe bashkërendon veprimtarinë e saj me organet e pushtetit gjyqësor dhe me prokurorinë, duke respektuar parimin e ndarjes së pushteteve dhe të pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe të prokurorisë.

Neni 6

Fusha e veprimtarisë

Ministria e Drejtësisë, në përputhje me drejtimit kryesorë të politikës së përgjithshme shtetërore dhe me programin e Qeverisë, ushtron veprimtarinë e saj në fushat si vijon:

1. Ndjek dhe përgjigjet për realizimin e politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e drejtësisë.

2. Harton projektet e akteve ligjore e nënligjore në fushën e drejtësisë.

3. Jep mendim të specializuar për projektet e akteve ligjore dhe të akteve nënligjore normative të Këshillit të Ministrave, të ministrave dhe të drejtuesve të institucioneve të tjera qendrore, si dhe për realizimin e reformimit të legjislacionit në përgjithësi.

4. Jep mendim të specializuar për përmbajtjen e projekteve të marrëveshjeve ndërkombëtare, që lidhen në emër të Republikës së Shqipërisë ose të Këshillit të Ministrave.

5. Përgatit dhe ndjek zbatimin e metodologjisë së unifikuar shqiptare për procesin ligjvënës, hartimin e akteve normative dhe terminologjinë juridike.

6. Ndjek dhe bashkërendon punët me institucionet e tjera dhe përgjigjet për procesin e realizimit të strategjisë së përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian.

7. Kujdeset për funksionimin dhe organizimin e pushtetit gjyqësor.

8. Drejton dhe kontrollon administratën gjyqësore.

9. Kryen inspektive dhe bën procedimin disiplinor të gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit sipas ligjit.

10. Kontrollon sipas ligjit organin e prokurorisë dhe raporton te Presidenti i Republikës dhe në Kuvend.

11. Mbështet dhe merr pjesë, sipas ligjit, në realizimin e funksioneve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

12. Drejton sistemin e paraburgimit dhe të ekzekutimit të vendimeve penale.

13. Drejton sistemin e ekzekutimit të vendimeve civile dhe të titujve ekzekutivë.

14. Drejton veprimtarinë e Qendrës së Publikimeve Zyrtare.

15. Drejton shërbimin e unifikuar statistikor në fushën e Drejtësisë.

16. Mban regjistrin e gjendjes gjyqësore dhe lëshon certifikatat në bazë të atij regjistrimi.

17. Realizon shërbimet juridiko-administrative, që sipas ligjit janë në kompetencë të Ministrit

të Drejtësisë.

18. Kujdeset për funksionimin dhe organizimin e avokatisë, noterisë, arbitrazhit, ndërmjetësimin, ndihmës juridike në fushën e drejtësisë dhe, në përgjithësi, për profesionet e lira juridiko-profesionale.

19. Mbështet dhe merr pjesë në bashkërendimin e veprimtarive me organet shtetërore, gjykatat dhe prokurorinë, lidhur me njohjen, studimin dhe masat për parandalimin dhe luftën kundër kriminalitetit dhe shkeljeve të ligjit.

20. Kujdeset dhe bashkërendon veprimtaritë për mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të ligjshme të të miturve në fushën e drejtësisë, si dhe për edukimin ligjor dhe parandalimin e shkeljeve të ligjit nga të miturit.

21. Drejton shërbimet e ekspertimit ligjor.

22. Kryen drejtimin metodik të shërbimeve të gjendjes civile.

23. Kryen drejtimin metodik të shërbimeve dhe të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

24. Kryen drejtimin metodik të zyrave juridike të ministrive dhe të institucioneve të tjera qendrore.

25. Kujdeset dhe mbështet veprimtaritë për përgatitjen profesionale, aftësimin dhe specializimin e gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve, noterëve dhe juristëve të administratës publike.

26. Kujdeset dhe mbështet veprimtaritë shkencore në fushën e drejtësisë dhe përhapjen e edukatës juridike.

27. Kujdeset për ndjekjen dhe bashkërendimin e marrëdhënieve me shoqërinë civile për fushën e drejtësisë.

28. Ndjek bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën penale dhe civile dhe, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare, ku shteti shqiptar është palë, realizimin e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet kompetente të shteteve të tjera, si dhe me organizma ndërkombëtarë.

29. Kryen funksione të tjera në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare ku shteti shqiptar është palë.

30. Kryen funksione dhe veprimtari të tjera në përputhje me ligjin.

KREU III ORGANIZIMI I MINISTRISË SË DREJTËSISË

Neni 7

Funksionarët politikë

1. Ministri i Drejtësisë ka në kompetencë dhe drejton nën përgjegjësinë e tij të gjithë fushat e veprimtarisë së Ministrisë të Drejtësisë.

2. Ministri i Drejtësisë, në zbatim të kompetencave të tij, nxjerr urdhra dhe udhëzime.

3. Ministri i Drejtësisë, në ushtrimin e kompetencave të tij, ndihmohet nga zëvendësministrat.

4. Ministri i Drejtësisë, në ushtrimin e kompetencave të tij, mbështetet nga Kabineti i Ministrit.

Neni 8

Shërbimi civil

Në përputhje me fushat e veprimtarisë, shërbimet civile të Ministrisë së Drejtësisë ushtrohen nga:

Sekretari i Përgjithshëm
Drejtoritë e Përgjithshme
Drejtoritë
Sektorët
Zyrat

Neni 9

Marrëdhëniet ndërmjet strukturave të Ministrisë së Drejtësisë

1. Të drejtat, detyrimet dhe marrëdhëniet ndërmjet Ministrit, Zëvendësministrit, Kabinetit të Ministrit, Sekretarit të Përgjithshëm dhe të strukturave të tjera të shërbimit civil të Ministrisë së Drejtësisë organizohen dhe funksionojnë në përputhje me dispozitat ligjore dhe aktet e tjera normative në fushën e shërbimit civil dhe ato për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave.

2. Ministri i Drejtësisë, në përputhje me ligjin dhe aktet normative të Këshillit të Ministrave, për përmbushjen e veprimtarive që ka në kompetencë, cakton a propozon për miratim rregulla të hollësishme për organizimin, funksionimin, strukturën dhe organikën e Ministrisë së Drejtësisë, lidhur me ndarjen dhe realizimin e detyrave ndërmjet funksionarëve politikë, nëpunësve civilë të niveleve drejtuese dhe atyre ekzekutuese, kriteret e veçanta për punësimin në strukturat e Ministrisë, disiplinën dhe rregullin e brendshëm në institucion, si dhe për drejtimin dhe administrimin e përditshëm të veprimtarisë së Ministrisë.

Neni 10

Drejtoria e Përgjithshme e Kodifikimit

1. Drejtoria e Përgjithshme e Kodifikimit përbëhet nga drejtoritë si vijon:

- Drejtoria e Legjislacionit dhe Asistencës Ligjore.
- Drejtoria e Përafrimit të Legjislacionit Shqiptar me atë të Bashkimit Europian.

2. Drejtoria e Legjislacionit dhe Asistencës Ligjore ushtron veprimtaritë si vijon:

a) harton projektet e ligjeve dhe të akteve nënligjore në fushën e drejtësisë ose në kompetencë të Ministrisë së Drejtësisë;

b) organizon dhe ndjek veprimtarinë e grupeve të posaçme të punës për përgatitjen e projektakteve;

c) ndjek procesin e shqyrtimit, të miratimit dhe publikimit të akteve ligjore dhe nënligjore normative;

ç) jep mendime juridike dhe opinione ligjore në rastet dhe mënyrën e përcaktuar me ligj dhe në marrëveshjet ndërkombëtare;

d) realizon drejtimin dhe udhëheqjen metodike të shërbimeve dhe të veprimtarive, sipas kompetencës së caktuar me ligj;

dh) përgatit mendimet juridike për projektligjet dhe projektaktet e tjera normative të Këshillit të Ministrave, të ministrave dhe institucioneve qendrore, si dhe për marrëveshjet ndërkombëtare që lidhen në emër të Republikës së Shqipërisë dhe të Këshillit të Ministrave,

e) organizon dhe kryen studime shkencore për fushën e drejtësisë dhe të legjislacionit, për strategjinë e reformave legjislative dhe të procesit legjislativ, për metodologjinë e hartimit të projektakteve, terminologjinë e unifikuar juridike, përgjithësimin e praktikës së zbatimit të legjislacionit dhe të dhënies së drejtësisë, si dhe mbështet, në përgjithësi, veprimtarinë shkencore në fushën e drejtësisë.

3. Drejtoria e Përafrimit të Legjislacionit Shqiptar me atë të Bashkimit Europian ushtron veprimtaritë si vijon:

a) përgatit projektstrategji, raporte dhe programe për përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Europian;

b) ndjek ecurinë e procesit të përafrimit të legjislacionit shqiptar dhe përputhshmërinë e tij me masat të tjera që ndërmerren në kuadrin e proceseve të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Europian;

c) mbikëqyr e bashkërendon punën me ministritë dhe institucione të tjera të interesuara, me shoqërinë civile dhe me strukturat kompetente të Bashkimit Europian për çështje të procesit të përafrimit të legjislacionit;

ç) ndjek zhvillimet e reja të legjislacionit në Bashkimin Europian, informon ministritë dhe institucionet e interesuara për legjislacionin në fushën përkatëse;

d) përgatit materiale orientuese për aspekte të veçanta të procesit të përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Europian;

dh) harton studime krahasuese me të drejtën europiane që sjellin vlerësime dhe perspektiva

përkatëse për procesin e përafrimit të legjislacionit;

e) jep mendim të specializuar për përputhshmërinë e projektligjeve dhe projektakteve normative me strategjinë e përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Europian dhe me Librin e Bardhë;

ë) kontribuon në përgatitjen profesionale dhe aftësimin e juristëve në këto fusha;

f) krijon, kujdeset dhe mirëmban bankën e të dhënave të legjislacionit shqiptar dhe atij të Bashkimit Europian, si dhe shpërndan në ministritë dhe institucionet e interesuara të gjithë informacionin e siguruar nga Bashkimi Europian, në lidhje me procesin e përafrimit të legjislacionit.

Neni 11

Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve të Drejtësisë

1. Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve të Drejtësisë përbëhet nga drejtoritë si vijon:

- Drejtoria e Organizimit Gjyqësor

- Drejtoria e Inspektimit

- Drejtoria e Profesioneve të Lira

2. Drejtoria e Organizimit Gjyqësor ushtron veprimtaritë si vijon:

a) përgatit rekomandime lidhur me masat ligjore dhe organizative për funksionimin e pushtetit gjyqësor, numrin e gjykatave, vendndodhjen dhe kompetencën territoriale të tyre, seksionet e gjykatave, organikën dhe numrin e gjyqtarëve të tyre, si dhe çështje të tjera të organizimit gjyqësor;

b) përgatit rekomandime lidhur me masat ligjore dhe organizative për funksionimin e administratës gjyqësore, organikën dhe numrin e personelit të administratës gjyqësore;

c) mbështet, bashkëpunon dhe bashkërendon punën e saj me Fakultetin e Drejtësisë, Shkollën e Magjistraturës dhe institucione të tjera vendase e të huaja, lidhur me çështje të përgatitjes profesionale, aftësimit dhe specializimit të gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve, noterëve dhe juristëve të administratës publike, si dhe të personelit të administratës gjyqësore;

ç) kujdeset për grumbullimin, përpunimin dhe mbajtjen e të dhënave statistikore të unifikuara procedurale, administrative, hetimore dhe gjyqësore, si dhe për metodikën dhe mënyrën e mbajtjes së statistikave gjyqësore penale dhe civile;

d) kujdeset për realizimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit lidhur me grumbullimin, përpunimin, ruajtjen dhe shkëmbimin e të dhënave në fushat e veprimtarisë së Ministrisë të Drejtësisë.

Drejtoria e Inspektimit ushtron veprimtaritë si vijon:

a) kryen inspektimin e gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit lidhur me organizimin dhe punën e shërbimeve gjyqësore dhe administrimin gjyqësor në përgjithësi, si dhe përgatit rekomandime për Ministrin e Drejtësisë lidhur me marrjen e masave të nevojshme për zgjidhjen e problemeve dhe për shkeljet e konstatuara;

b) kryen inspektime në gjykata dhe gjyqtarë të veçantë, sipas ligjit dhe përgatit rekomandime për Ministrin e Drejtësisë lidhur me marrjen e masave të nevojshme për zgjidhjen e problemeve dhe për shkeljet e konstatuara;

c) Kontrollon organin e prokurorisë dhe përgatit rekomandime për Ministrin e Drejtësisë, lidhur me çështjet objekt të inspektimit;

ç) kryen inspektimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve civile dhe penale, si dhe të institucioneve të tjera në varësi të Ministrisë së Drejtësisë ose që ushtrojnë veprimtari në kompetencë të saj, si dhe përgatit rekomandime për Ministrin e Drejtësisë, lidhur me marrjen e masave të nevojshme për zgjidhjen e problemeve dhe për shkeljet e konstatuara.

4. Drejtoria e Profesioneve të Lira ushtron veprimtaritë si vijon:

a) ndjek, në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore, funksionimin dhe organizimin e avokatisë dhe të noterisë, të dhomave dhe zyrave të avokatëve ose noterëve;

b) ndjek, në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse, funksionimin dhe organizimin e arbitrazhit, ndërmjetësimit, ndihmës juridike dhe të veprimtarive a profesioneve të tjera të lira, të personave fizikë dhe juridikë të autorizuar për ushtrimin e këtyre veprimtarive;

c) kujdeset dhe mbështet funksionimin e veprimtarisë dhe të shërbimeve të përkthimit dhe ekspertimeve ligjore, si dhe ndjek çështje të tjera në përputhje me dispozitat përkatëse të akteve ligjore që rregullojnë veprimtarinë e tyre.

Neni 12

Drejtoria e Marrëveshjeve Ndërkombëtare dhe Marrëdhënieve Juridiksionale

Drejtoria e Marrëveshjeve Ndërkombëtare dhe Marrëdhënieve Juridiksionale ushtron veprimtaritë si vijon:

a) ndjek dhe realizon procesin e studimit, negocimit, nënshkrimit, miratimit dhe zbatimit të marrëveshjeve ndërkombëtare që janë në kompetencë të Ministrit të Drejtësisë;

b) në përputhje me ligjin dhe marrëveshjet ndërkombëtare ndjek dhe realizon ushtrimin e kompetencave të Ministrit të Drejtësisë lidhur me zhvillimin dhe realizimin e marrëdhënieve juridiksionale dhe procedurave të tjera të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën penale dhe civile;

c) siguron dhe realizon përkthimin zyrtar, nga gjuha shqipe në gjuhë të huaj dhe anasjelltas, të legjislacionit shqiptar, të legjislacionit të shteteve të tjera dhe të akteve të së drejtës ndërkombëtare;

ç) në rastet dhe mënyrat e parashikuara nga ligji, marrëveshjet ndërkombëtare dhe praktikrat përkatëse të gjithëpranuara, realizon përkthimet e dokumenteve dhe shkresave të tjera zyrtare;

d) realizon edhe shërbimin e përkthimit zyrtar, si dhe të përkthimit të projekteve të ligjeve dhe të akteve normative që dërgohen zyrtarisht në shtete të tjera dhe në institucione ndërkombëtare.

Këshilli i Ministrave cakton rastet e zbatimit dhe libri i tarifave të shërbimit të përkthimeve zyrtare, që duhet të paguajnë të tretët, sipas shkronjave “c”, “ç” dhe “d” të këtij neni.

Neni 13

Drejtoria e Shërbimeve Juridiko-Administrative

Drejtoria e Shërbimeve Juridiko-Administrative ushtron veprimtaritë si vijon:

a) kujdeset për grumbullimin, përpunimin dhe ruajtjen e skedave dhe të regjistrit të gjendjes gjyqësore, si dhe për lëshimin e dëshmive përkatëse në bazë të këtij regjistri;

b) harton programe, studime dhe kujdeset për bashkërendimin e punëve dhe të masave të nevojshme ligjore për trajtimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të të miturve në fushën e drejtësisë, si dhe për masat e nevojshme për edukimin ligjor, parandalimin e shkeljeve të ligjit dhe luftën kundër kriminalitetit të të miturit;

c) ndjek dhe realizon shërbimet juridiko-administrative që sipas ligjit janë në kompetencë të Ministrit të Drejtësisë.

Neni 14

Drejtoria e Personelit, Organizimit dhe Shërbimeve

Drejtoria e Personelit, Organizimit dhe Shërbimeve ushtron veprimtaritë si vijon:

a) studion dhe merr masa për plotësimin e nevojave të Ministrisë lidhur me burimet njerëzore, për përzgjedhjen dhe aftësimin profesional të specialistëve dhe punonjësve të thjeshtë të Ministrisë, si dhe administron dokumentacionin e personelit;

b) kontrollon respektimin e ligjit dhe të rregullave të funksionimit të brendshëm të Ministrisë, si dhe ndjek procedurat lidhur me marrjen e masave disiplinore ndaj nëpunësve civilë dhe punonjësve në kompetencë të Ministrit;

c) kujdeset për administrimin, inventarizimin dhe mirëmbajtjen e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të Ministrisë;

ç) kujdeset për planifikimin dhe zbatimin e programit vjetor për investimet dhe furnizimin e Ministrisë me pajisje dhe materiale të çdo lloji për mbajtjen e inventarëve dhe administrimin e magazinës;

d) kujdeset për funksionimin mjeteve të komunikimit, për shpërndarjen dhe lëvizjen e automjeteve, për pastërtinë dhe rregullin në mjediset e punës, për ruajtjen dhe sigurinë e tyre, si dhe përmbush shërbimet e tjera të nevojshme për veprimtarinë e strukturave të Ministrisë;

dh) ndjek dhe realizon të gjitha veprimtaritë që lidhen me lëvizjen e korrespondencës brenda dhe jashtë Ministrisë, arkivën, protokollin, daktilografimin dhe riprodhimin e shkresave dhe formularëve;

e) kujdeset, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, për mbajtjen, ruajtjen dhe

përdorimin e arkivave në sistemin e drejtësisë;

ë) kujdeset dhe mbështet bashkëpunimin e Ministrisë së Drejtësisë me institucione homologe dhe autoritete gjyqësore të shteteve të tjera, organizma dhe institucione ndërkombëtare, institucione publike dhe private të tjera të huaja, për pjesëmarrjen dhe organizimin e veprimtarive ndërkombëtare, brenda dhe jashtë shtetit;

f) ndjek dhe merr masa për mjetet e komunikimit dhe marrëdhëniet me publikun për qartësimin, sqarimin dhe thjeshtëzimin e veprimeve dhe të shkresave administrative të Ministrisë, si dhe për pritjen, informimin dhe shqyrtimin korrekt të ankesave dhe kërkesave të publikut;

g) ndjek dhe merr masa për kërkimin, përpunimin, ruajtjen, përdorimin dhe shkëmbimin e informacionit brenda dhe jashtë Ministrisë, si dhe merr masa për komunikimin dhe shkëmbimin e informacionit me organet e shtypit dhe të masmediave;

gj) ndjek dhe realizon veprimet për mbajtjen e llogarisë, të librave kontabël dhe të arkës.

Neni 15

Drejtoria Ekonomike

Drejtoria Ekonomike ushtron veprimtaritë si vijon:

a) kujdeset për njohjen e gjendjes dhe për përmbushjen e procedurave të përpilimit të kërkesave buxhetore të Ministrisë;

b) merr masa për programimin, planifikimin, sigurimin dhe zbatimin e buxhetit të miratuar për realizimin e fondeve financiare dhe të investimeve në fushat e veprimtarisë së Ministrisë;

c) programon, organizon dhe realizon kontrolle dhe inspektime për respektimin e disiplinës financiare dhe buxhetore nga të gjitha strukturat përbërëse ose në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.

Neni 16

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve është institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë që, sipas ligjit, ndjek e realizon organizimin dhe funksionimin e sistemit të paraburgimit, të ekzekutimit të vendimeve penale, të vuajtjes së dënimit dhe të trajtimit të të ndaluarve, të arrestuarve dhe të dënuarve me burgim.

Neni 17

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Përmbarimor

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Përmbarimor është institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë që, sipas ligjit, ndjek dhe realizon organizimin dhe funksionimin e sistemit të ekzekutimit të vendimeve civile dhe të titujve ekzekutivë.

Neni 18

Qendra e Publikimeve Zyrtare

Qendra e Publikimeve Zyrtare është institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë që, sipas ligjit, ushtron veprimtarinë e publikimeve dhe botimeve zyrtare juridike, të teksteve juridiko-profesionale, si dhe veprimtari të tjera për publikimin dhe njohjen e legjislacionit.

KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 19

Ligji nr.7381, datë 8.5.1990 “Për krijimin e Ministrisë së Drejtësisë”, me ndryshimet e mëvonshme dhe çdo dispozitë që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 20

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3026, datë 24.5.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

Fletorja Zyrtare gjendet në:

1. Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
2. Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare,
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 5.6. 2001
Doli nga shtypi më 5.6.2001

Tirazhi: 4100 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2001

Çmimi 100 lekë